

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2710 / Prot. 22

Durrës, më 21.11.2025

V E N D I M

Nr. 158, datë 21.11 2025

PËR

**"NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 55, DATË 15.09.2022 "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE "DOKTORATË" NË "SHKENCA EKONOMIKE", TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Statutin e UAMD-së; në Rregulloren e UAMD-së; në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 55, datë 15.09.2022 "Për miratimin e Rregullores së ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Shkenca Ekonomike" të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës"; referuar shkresës Nr. 1366/4 prot., datë 07.11.2025 të Fakultetit të Biznesit; si dhe të shkresës 1366/5 prot., datë 18.11.2025 të Drejtorisë Juridike, në mbledhjen e datës 21.11.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 55, datë 15.09.2022 "Për miratimin e Rregullores së ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Shkenca Ekonomike" të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - Zv. Rektorët
  - Drejtuesi i Njësisë Kryesore i Fakultetit të Biznesit
  - Drejtorja e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës**  
**FAKULTETI I BIZNESIT**

**Rregullore e programit**  
**"Doktoratë"**  
**në**  
**Shkenca Ekonomike**

2025





## KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja e Brendshme e studimit të Ciklit të Tretë të Doktoratës në Shkenca Ekonomike është hartuar, mbështetur në;

1. Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë",
2. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar,
3. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar,
4. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26.12.2018, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore", i ndryshuar,
5. Vendimin nr. 824, datë 24.12.2021 për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë,
6. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018, "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor",
7. Udhëzimin e MASR nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar,
8. Udhëzimin e MASR nr. 16, datë 08.07.2019, "Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave",
9. Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.09.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor",
10. Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 18.12.2019 "Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë",
11. Udhëzimin e MASR nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar,
12. Udhëzimin e MASR nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurën e regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor",
13. Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL",
14. Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,
15. Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,
16. Kodin e Etikës së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,
17. Kodin e Etikës në Kërkimin Shkencor të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës,
18. Rregulloren e ciklit të tretë të studimeve Doktoratë të UAMD.







## Neni 2

### Objekti i rregullores

Rregullorja e Brendshme e studimeve të Ciklit të Tretë "Doktoratë" në Shkenca Ekonomike vendos rregullat normative të funksionimit të Doktoratës në këtë fushë dhe krijimin e marrëdhënieve midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e Doktoratës në profilin Shkenca Ekonomike. Rregullorja përcakton misionin, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të Doktoratës në këtë fushë, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, personelit akademik dhe administrativ, studentëve, bashkëpunëtorëve të jashtëm, raportet midis tyre, rregullat për pranimin e studentëve, kërkimin, praktikën, vlerësimin, diplomimin, publikimet, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastet e shkeljes së rregullores.

## Neni 3

### Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka si qëllim të përcaktojë kuadrin e brendshëm rregullativ e procedural, mënyrat dhe kërkesat, që duhet të plotësohen për përfshirjen e stafit akademik dhe atij mbështetës për zhvillimin e studimeve në ciklin e tretë të studimeve "Doktoratë" në Fakultetin e Biznesit. Përcaktimet e kësaj rregulloreje rrjedhin dhe janë në përputhje me detyrimet, të drejtat, kushtet e procedurat që parashikohen në kuadrin ligjor e nënligjor, në fuqi, në bazë dhe zbatim të të cilit duhet të zhvillohen studimet e doktoratës.

## Neni 4

### Statusi i studimeve "Doktoratë" në Shkenca Ekonomike

Programi i studimit "Doktoratë" në Shkenca Ekonomike bën pjesë në Ciklin e Tretë të Studimeve dhe zhvillohet në nivel njësie kryesore pranë Fakultetit të Biznesit. Ky program zbatohet në kuadër të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet gjashtë njësisë bazë të këtij fakulteti, të cilat janë:

- Departamenti i Shkencave Ekonomike
- Departamenti i Marketingut
- Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- Departamenti i Menaxhimit
- Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar
- Departamenti i Turizmit

Studimet në këtë program realizohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë. Në raste të veçanta, kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, programi mund të ndiqet edhe me kohë të zgjatur, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

## Neni 5

### Misioni i studimeve "Doktoratë" në Shkenca Ekonomike

Misioni i studimeve në ciklin e tretë "Doktoratë" në Shkenca Ekonomike është kualifikimi, edukimi dhe përgatitja e kërkuesëve të pavarur në nivel të lartë, në përputhje me parimet e njohura shkencore e etike. Nëpërmjet studimeve të thelluara dhe të avancuara në teorinë dhe në kërkimin shkencor në fushat e





Shkencave Ekonomike, këto studime synojnë të realizojnë zhvillimin e aftësive të kandidatëve për kërkim shkencor që kërkojnë përgatitje të lartë dhe të thelluar profesionale e shkencore. Ato ndihmojnë në zhvillimin e të menduarit analitik, gjykimin dhe analizën e thelluar të dukurive, që janë objekt studimi i kërkimit shkencor në Shkenca Ekonomike.

## Neni 6 Parimet

Doktorata në Shkenca Ekonomike e zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të parimeve të lirisë akademike, autonomisë institucionale dhe cilësisë.

1. *Liria akademike* nënkupton lirinë e personelit akademik, studentëve në ndjekjen e dijes në çdo drejtim dhe kudo që ajo i udhëheq, pa asnjë ndikim nga jashtë apo brenda, në çdo proces e veprimtari që ata realizojnë. Ajo vështrohet si një parakusht për mendimin kritik, krijues si dhe për avancimin e dijeve dhe të kërkimit intelektual.
2. *Autonomia institucionale* i referohet shkallës së vetërregullimit dhe të pavarësisë së saj, sipas së cilës:
  - a) miraton vetë strategjinë e zhvillimit;
  - b) miraton vetë programet mësimore;
  - c) ngre këshilla dhe komisione për realizimin e misionit të saj;
  - d) ka të drejtën e përdorimit të ndërtesave dhe të pasurive të tjera të dhëna nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ose dhurues të ndryshëm sipas legjislacionit në fuqi.
3. *Parimi i cilësisë* nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, të infrastrukturës si në aspektin e kërkesave edhe të pritshmërive, dhe kodit etik, të cilat duhet të plotësohen për të arritur idealin e përsosmërisë. Zbatimi i parimit të cilësisë nënkupton realizimin e vlerësimit të brendshëm, të vetëvlerësimit, të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit, duke synuar përmirësimin, ndryshimin, përparimin dhe njohjen zyrtare të cilësisë së Doktoratës në Shkenca Ekonomike.

## Neni 7 Paraqitja e projekteve për kërkim shkencor në programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë"

### 1. Paraqitja e Projekteve Kërkimore

Në muajin Nëntor të çdo viti, personeli akademik efektiv i Njësive Bazë, që mbajn titullin akademik të kategorisë "Profesor", ka të drejtën e paraqitjes pranë Njesisë Bazë projektet kërkimore afatgjata shkencore, me qëllim përfshirjen e tyre në programin e studimeve të doktoratës. Projektet paraqiten për konkurrim në Njësinë Bazë përkatëse, në përputhje me fushat dhe prioritetet e miratuara të kërkimit shkencor. Ato mund të dorëzohen individualisht ose në grup.

Pjesë e projekteve mund të jenë edhe pjesëtarë të stafit akademik të kategorisë "Profesor" nga fakultetet e tjera të Universitetit "Aleksandër Moisiu", si dhe nga universitete të tjera kombëtare ose nga Diaspora, me kusht që këta bashkëpunëtorë të jenë të përfshirë në projektet kërkimore që propozon Njësia Bazë. Në rast se Njësia Bazë ka nevojë për bashkëpunëtorë të jashtëm, ajo është përgjegjëse për kërkimin dhe formulimin e kërkesës për përfshirjen e këtyre individëve, duke e argumentuar nevojën dhe rëndësinë e kontributit të tyre në realizimin e objektivave të projektit. Kjo kërkesë i dërgohet Njesisë Kryesore, që është përgjegjëse për koordinimin dhe mbikëqyrjen e bashkëpunimeve ndër-institucionale.



Njësia Kryesore duhet të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përkatëse, përfshirë universitetet kombëtare dhe ato të Diasporës, për të siguruar përfshirjen e stafit akademik nga këto institucione. Kjo marrëveshje duhet të përmbajë detaje të qarta mbi rolin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe mbi format e bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe duhet të nënshkruhet përpara se të miratohet përfshirja e këtyre individëve në projekt.

Në dokumentin e projektit, Njësia Bazë duhet të përcaktojë qartë edhe numrin e studentëve doktorantë që do të përfshihen në realizimin e projektit, për të siguruar që ata të kenë mundësi të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga ky kërkim.

## **2. Udhëheqja e Projekteve Kërkimore**

Projektet kërkimore mund të drejtohen nga një udhëheqës shkencor i kategorisë “Profesor” ose nga më shumë se një udhëheqës shkencor, në rastet e bashkëudhëheqjes. Bashkëudhëheqja pranohet vetëm kur fushat e studimit janë ndërdisiplinore dhe kërkohet ekspertizë e gjerë, që justifikon përfshirjen e më shumë se një udhëheqësi. Në rastet e bashkëudhëheqjes, kjo duhet të përcaktohet qartë që në momentin e paraqitjes së projektit, dhe detyrat e secilit udhëheqës shkencor duhet të jenë të specifikuara saktë.

## **3. Përzgjedhja dhe Miratimi i Projekteve Kërkimore**

Njësia Bazë është përgjegjëse për përzgjedhjen e projekteve kërkimore shkencore që do të paraqiten për miratim, së bashku me kuotat potenciale për studentët e doktoratës, brenda datës 30 nëntor të çdo viti. Kuotat i përcillen Senatit Akademik për miratim pasi janë miratuar nga Dekanati dhe Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”. Në rastet kur projekti është hartuar me kërkesën e një subjekti të tretë, i cili ofron mbështetje financiare për realizimin e tij, Njësia Bazë ia përcjell projektin për miratim Dekanatit.

# **KREU II**

## **KRITERET E APLIKIMIT, PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE PRANIMIT TË KANDIDATËVE FITUES**

### **Neni 8**

#### **Politika e pranimit dhe kriteret e përzgjedhjes**

1. Çdo vit akademik, në programin e studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë” në Shkenca Ekonomike pranohen kandidatë nga Shqipëria, Kosova, trojet shqiptare, diaspora, si dhe nga vende të tjera.
2. Kriteret e pranimit për kandidatët e doktoratës hartohen nga njësitë bazë përkatëse dhe, së bashku me metodologjinë e vlerësimit (pikëzimin), i përcillen Dekanatit të Fakultetit të Biznesit brenda muajit dhjetor për vitin akademik pasardhës. Pas shqyrtimit dhe miratimit nga Dekanati, këto kriterë bëhen pjesë e dokumentacionit zyrtar të pranimit.

Për t’u pranuar në programin e doktoratës, kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a. Të ketë përfunduar studimet e larta në fushën e kërkuar dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”, një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente.
- b. Të njohë të paktën një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testimeve të njohura ndërkombëtare ose përmes diplomës së fituar në një nga këto gjuhë.





- c. Të ketë notë mesatare të ponderuar të ciklit të parë dhe të dytë sipas përcaktimeve të kodit të cilësisë në arsimin e lartë.
  - d. Të ketë angazhim akademik pranë një institucioni të arsimit të lartë ose në kërkimin shkencor në institucione të kërkimit bazë ose të zbatuar.
  - e. Të ketë dy rekomandime nga persona akademikë me titull "Profesor i Asociuar" ose "Profesor".
  - f. Të mos ketë masa disiplinore për shkelje të etikës akademike, përfshirë plagjiaturë, vjedhje të pronësive intelektuale apo shkelje të rënda të normave etike.
3. Çdo kandidat duhet të aplikojë me një propozim individual për projekt kërkimor-shkencor, i dakordësuar paraprakisht me udhëheqësin ose udhëheqësit e mundshëm. Propozimi duhet të jetë në përputhje me temat e projekteve të doktoratës të miratuara nga njësitë bazë.
  4. Njoftimi për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë, numrin e vendeve të disponueshme, projektet kërkimore-shkencore, kriteret e përzgjedhjes dhe procedurat përkatëse bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, jo më vonë se një muaj para datës së konkurrit.

### Neni 9

#### Dokumentacioni i Aplikimit

1. Kandidatët konkurrojnë me dosje. Dosjet duhet të dorëzohen me postë dhe të inventarizohen nga Zëvendësdekani përgjegjës për programin e studimeve të ciklit të tretë. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:
  - a. Kërkesë drejtuar njësisë bazë, përgjegjëse për drejtimin dhe zbatimin e projektit kërkimor-shkencor përkatës.
  - b. Curriculum Vitae dhe bibliografi e punimeve shkencore (nëse ka), të dokumentuara.
  - c. Kopje të noterizuara të diplomave të fituara, të shoqëruara me suplementet përkatëse të diplomës ose listën e notave me kreditet. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes ose ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin.
  - d. Certifikatë lindjeje dhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës
  - e. Dy fotografi.
  - f. Dy letra rekomandimi nga persona me titullin akademik "Profesor".
  - g. Dëshmi të mbrojtjes së gjuhës së huaj sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.
  - h. Dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore;
  - i. Deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
  - j. Mandat-pagesa e tarifës së aplikimit.
  - k. Deklaratë vetjake e kandidatit për përballimin financiar të programit të studimeve në rast vetëfinancimi.
  - l. Projekt-propozim për studimet e doktoratës, ku përcaktohet fusha e interesit dhe emri i udhëheqësit shkencor. Projekti duhet të jetë në përputhje me fushat e miratuara të projektit kërkimor-shkencor dhe zhvillimor të njësisë bazë dhe të përgatitet sipas formatit të përcaktuar në shtojcat e kësaj rregulloreje.
  - m. Vërtetim nga institucioni i punës që konfirmon se kandidati është i angazhuar akademikisht në një institucion të arsimit të lartë ose është pjesë e një institucioni kërkimor;
  - n. Vetëdeklarim i kandidatit për respektimin e standardeve shkencore dhe etike.
  - o. Dokumenta të tjera që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve të shpallura në thirrje.
2. Aplikimet që nuk përmbajnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nuk do të merren në shqyrtim.





- 
3. Dokumentet e dërguara me postë nuk i kthehen aplikantit pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes.
  4. Pas dorëzimit të dosjes, nuk lejohet asnjë ndryshim apo plotësim i dokumentacionit.

#### Neni 10

##### Procedura e Përzgjedhjes së Kandidatëve

1. Dosja e aplikimit të kandidatit verifikohet nga Zëvendësdekani i ngarkuar për programin e studimeve të ciklit të tretë, për përmbushjen e kriterëve të dokumentacionit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Pas verifikimit, dosja i përcillet njësisë bazë përkatëse brenda 10 ditëve nga data e dorëzimit.
2. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet nga njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të doktoratës. Kandidatët që janë personel akademik të punësuar me kohë të plotë në UAMD kanë përparësi në procesin e përzgjedhjes.
3. Pranë çdo njësie bazë ngrihet një Komision “ad hoc” për përzgjedhjen e kandidatëve, i cili miratohet nga Dekanati. Ky komision është përgjegjës për vlerësimin e dosjeve të aplikantëve.
4. Komisioni “ad-hoc” përbëhet nga tre deri në pesë anëtarë. Kryetar i komisionit është drejtuesi i njësisë bazë, nëse ai mban titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”. Në rast se drejtuesi nuk zotëron këto tituj, kryetar emërohet një anëtar tjetër që i plotëson këto kriterë. Udhëheqësi shkencor është gjithashtu pjesë e komisionit. Në rastet kur drejtuesi i njësisë bazë është gjithashtu udhëheqës shkencor, komisioni duhet të ketë të paktën katër anëtarë. Nëse ndonjë nga departamentet nuk ka anëtarë të titullit “Profesor”, njësia bazë propozon anëtarë nga departamentet e tjera të Fakultetit të Biznesit.
5. Komisioni “ad-hoc” vlerëson kandidatët sipas kriterëve dhe çelësit të pikëzimit të përcaktuar më parë nga njësia bazë dhe të miratuar nga Dekanati, duke marrë në konsideratë projektin kërkimor, përmbushjen e kriterëve akademike dhe cilësinë e dokumentacionit të dorëzuar.
6. Brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimeve, komisioni i përcjell Dekanatit listën me kandidatët e përzgjedhur. Njësia bazë i dërgon Dekanit, përmes shkresës zyrtare, listën e kandidatëve fitues. Dekani mbledh Dekanatin për shqyrtimin dhe miratimin e listës brenda një jave nga data e njoftimit.
7. Lista e kandidatëve të përzgjedhur nga Komisioni “ad hoc”, pasi miratohet nga Dekanati, publikohet në faqen zyrtare të Universitetit dhe u komunikohet kandidatëve përmes rrugëve elektronike.
8. Pas publikimit të listës së kandidatëve fitues, kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë procedurën e vlerësimit brenda pesë (5) ditëve të punës nga njoftimi në rrugë elektronike dhe shpallja e listës së kandidatëve fitues. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë e doktoratës jo më vonë se 10 ditë pas marrjes së njoftimit për kualifikimin të kërkesës së tyre.
9. Dosja fizike dhe elektronike e doktorantit ruhet pranë sekretarisë së doktoratës, e cila është përgjegjëse për administrimin dhe arkivimin e saj.
10. Midis kandidatit fitues, udhëheqësit shkencor dhe përgjegjësit të programit të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore lidhet një kontratë tip, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet përkatëse të palëve.

#### Neni 11

##### Regjistrimi i Studentëve

1. Kandidatët fitues të shpallur fitojnë statusin e studentit dhe kanë të drejtë të ndjekin studimet në vitin akademik përkatës, nëse regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit, pasi kanë



  
dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm juridik, brenda afateve kohore të përcaktuara dhe të shpallura paraprakisht.

2. Pas përfundimit të afatit të ankesave dhe shqyrtimit të tyre, sekretaria e doktoratës njofton fituesit për t'u paraqitur për regjistrim brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e njoftimit.
3. Nuk lejohet regjistrimi i një kandidati njëkohësisht në më shumë se një program doktorature.

#### Neni 12

##### Procedura e ankimimit

1. Kandidatit i lind e drejta e ankimimit brenda 5 ditëve të punës nga data e publikimit të listës paraprake të kandidatëve fitues në faqen zyrtare të universitetit dhe/ose nga njoftimi përmes rrugëve elektronike.
2. Ankimimi paraqitet me shkrim pranë sekretarisë së doktoraturës së njësisë kryesore dhe i përcillet drejtuesit të njësisë bazë përkatëse.
3. Drejtuesi i njësisë bazë thërret mbledhjen e departamentit për shqyrtimin e ankimimit brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Departamenti shqyrton pretendimet e paraqitura dhe merr vendim për pranimin ose rrëzimin e ankesës.
4. Mbledhja e departamentit është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën gjysma plus një e anëtarëve me të drejtë vote, duke siguruar kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje. Vendimi merret me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në mbledhje dhe është përfundimtar dhe i paankimueshëm.

#### Neni 13

##### Marrëveshja midis palëve

Pranimi i studentit në programin e doktoratës formalizohet nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim, e cila nënshkruhet nga studenti i doktoratës, udhëheqësi ose udhëheqësit shkencor, koordinatori i programit të studimit të doktoratës dhe drejtuesi i njësisë bazë përkatëse. Kjo marrëveshje përcakton të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, duke përfshirë aspektet që lidhen me ndjekjen e studimeve, procesin e udhëheqjes shkencore, raportimet periodike, publikimet e kërkuara, mënyrën e financimit të studimeve (kur është e aplikueshme), si dhe rregullat për pronësinë intelektuale të rezultateve të kërkimit shkencor. Marrëveshja firmoset brenda një afati prej 15 ditësh nga momenti i regjistrimit të studentit dhe ruhet pranë sekretarisë së doktoraturës, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjes së doktorantit.

### KREU III

#### DREJTIMI DHE ORGANIZIMI I DOKTORATËS NË SHKENCA EKONOMIKE

#### Neni 14

##### Autoritetet dhe organet përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e studimeve të doktoratës në Shkenca Ekonomike

Programi i studimeve të ciklit të tretë në "Doktoratë" ofrohet nga Fakulteti i Biznesit, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD), i cili është përgjegjës për drejtimin, administrimin dhe funksionimin e tij, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me Rregulloren e Studimeve të UAMD-së.

Studimet e doktoratës në Shkenca Ekonomike zhvillohen nën përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen e







autoriteteve dhe organeve të mëposhtme:

1. Dekani i Fakultetit të Biznesit
2. Njësitë bazë
3. Koordinatori i programit të ciklit të tretë të studimeve doktorale në Shkenca Ekonomike
4. Udhëheqësi shkencor
5. Personeli ndihmës akademik dhe administrativ, i ngarkuar me mbështetjen e programit të ciklit të tretë
6. Komisioni për Vlerësimin Periodik të Ecurisë së Programit Individual të Doktoratës
7. Komisioni i Përhershëm për Dhënie të Gradës Shkencore "Doktor".

#### Neni 15

##### Dekani i Fakultetit të Biznesit

Dekani ka këto detyra:

1. Miraton në Dekanat, brenda datës 15 dhjetor, listën e projekteve të dorëzuara nga njësitë bazë, pas verifikimit të përputhshmërisë së tyre me programet e kërkimit shkencor të miratuara në Planin e Kërkimit Shkencor të Fakultetit.
2. Miraton në Dekanat kriteret për pranimin e doktorantëve, të propozuara nga njësitë bazë.
3. Miraton në Dekanat komisionet Ad-Hoc për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve për doktoratë, të propozuara nga njësitë bazë.
4. Miraton në Dekanat, brenda 10 ditëve, listën përfundimtare të kandidatëve fitues të përzgjedhur për t'u regjistruar në programin e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë".
5. Përcjell në Senat listën e projekteve fituese të miratuara në Dekanat.
6. Lidh marrëveshje bashkëpunimi, mbi bazën e kërkesave të Njësive Bazë, me fakultete të tjera të Universitetit "Aleksandër Moisiu" apo me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare (përfshirë institucionet e diasporës), për zhvillimin e projekteve kërkimore në kuadër të programit të doktoratës.
7. Miraton komisionet e vlerësimit periodik të doktorantëve.
8. Përcjell brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për vlerësim disertacionin dhe dosjen e plotë të doktorantit në Njësine Bazë.
9. Miraton propozimin e Njesisë Bazë për anëtarët e jurisë për mbrojtjen publike të doktoraturës.
10. Miraton, me propozim të Drejtuesit të Njesisë Bazë dhe Koordinatorit të programit të doktoraturës, datën, vendin dhe orën për mbrojtjen përfundimtare, publike, të disertacionit të paraqitur për marrjen e gradës shkencore "Doktor".

#### Neni 16

##### Njësitë Bazë

1. Njësia bazë është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës dhe drejtimin e kërkimit shkencor në kuadër të programit të doktoratës.
2. Njësia bazë përcakton dhe miraton projektet kërkimore shkencore të doktoratës, brenda të cilave realizohen projektet e doktorantëve. Ajo siguron mbikëqyrjen dhe monitorimin e zhvillimit të tyre, duke garantuar përmbushjen e kërkesave shkencore dhe akademike.
3. Njësia bazë përcakton kriteret për pranimin e studentëve doktorantë, shqyrton dhe miraton listën e kandidatëve fitues në programin e doktoratës dhe përcakton kuotat për çdo projekt kërkimor.
4. Njësia bazë organizon ngritjen e komisioneve ad hoc për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve, si dhe komisioneve të vlerësimit periodik të doktorantëve, për të siguruar një proces objektiv dhe të mirëorganizuar të vlerësimit.
5. Njësia bazë informon studentët e pranuar në programin e doktoratës për aktet ligjore dhe



nënligjore përkatëse, përshfaqet këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.

6. Në rastin e kërkesës për ndryshimin e temës së dizertacionit, doktoranti paraqet një raport drejtuar drejtuesit të njësisë bazë, të nënshkruar nga ai dhe udhëheqësi, ku argumentohet ndryshimi i temës. Tema duhet të jetë brenda fushës së kërkimit dhe pjesë e projektit kërkimor shkencor të udhëheqësit shkencor. Drejtuesi i njësisë bazë merr vendim për miratimin ose jo të ndryshimit të temës së dizertacionit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i kërkesës. Kërkesa për ndryshimin e temës mund të bëhet jo më vonë se në fund të tremujorit të tretë të studimeve.
7. Njësia bazë shqyrton raportet e ecures së kërkimit shkencor të paraqitura nga doktorantët dhe udhëheqësit, duke siguruar kontakte të rregullta ndërmjet tyre. Kur konstatohet ndonjë problem, ajo propozon ndryshime dhe i paraqet për shqyrtim dhe miratim Komisionit të Vlerësimit Periodik.
8. Njësia bazë organizon procesin e kontrollit për vlerësimin periodik të ecures së kërkimit shkencor që realizohet në kuadër të projektit kërkimor për doktoratë.
9. Njësia bazë është përgjegjëse për sigurimin e përmbushjes së kriterëve formale dhe atyre të antiplagjiaturës nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor". Për këtë qëllim, ajo i drejtohet Komisionit të Integritetit Akademik të Fakultetit të Biznesit (KIAF) për kontroll dhe raportim mbi plagjiaturën e dizertacionit.
10. Njësia bazë bën vlerësimin e dizertacionit dhe të dosjes së kandidatit dhe e përcjell për vlerësim pranë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".
11. Njësia bazë i propozon Dekanit juridike e vlerësimit të dizertacionit.
12. Në bashkëpunim me koordinatorin e programit të Ciklit të Tretë të Doktoratës, njësia bazë përgatit raportin vjetor për ecurinë e programit dhe e paraqet për shqyrtim dhe analizë në Komisionin e Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".

#### Neni 17

##### Kordinatori I Doktoraturës

Programi i doktoraturës në Fakultetin e Biznesit zhvillohet në nivel të njësisë kryesore dhe drejtohet nga Koordinatorin i Programeve të Doktoraturës, i cili është njëkohësisht Zëvendësdekani për Ciklin e Tretë të Studimeve. Koordinatorin ushtron këto kompetenca dhe detyra:

1. Kryen inventarizimin e dosjeve të aplikantëve, duke verifikuar plotësinë dhe rregullsinë e dokumentacionit dhe i përcjell ato, me procesverbal, pranë njësive bazë për shqyrtim të mëtejshëm.
2. Mbikëqyr respektimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi nga njësia bazë, përfshirë respektimin e rregullores së universitetit, afatet dhe kriteret për shpalljen dhe zhvillimin e programit të doktoraturës, procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, si dhe kriteret për përzgjedhjen e udhëheqësve shkencorë (titulli akademik, numri maksimal i doktorantëve etj.). Në rast të konstatimit të shkeljeve të kuadrit ligjor apo rregullator, Koordinatorin përgatit një raport të argumentuar dhe e paraqet atë pranë Dekanit dhe Komisionit të Përhershëm për Gradën Shkencore "Doktor". Në bashkëpunim me këto struktura, merren masat përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, pezullimin e përkohshëm të procedurave deri në verifikimin dhe adresimin e shkeljes.
3. Vepron si hallkë ndërlidhëse ndërmjet doktorantëve, Drejtuesit të Njesisë Bazë dhe Komisionit të Përhershëm për Gradën Shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore.
4. Siguron informimin e vazhdueshëm të doktorantëve lidhur me të gjitha aktet ligjore, nënligjore, rregullore dhe udhëzime që lidhen me procesin e përfitimit të gradës shkencore "Doktor".







5. Mbi bazën e kriterëve të përcaktuara për pranimin e kandidatëve dhe kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi, përgatit listën dhe formatet e dokumenteve që kandidatët duhet të dorëzojnë për pranimin në programin e doktoratës në Shkenca Ekonomike. Këto dokumente i përcillen Drejtuesit të Njesisë Bazë dhe Dekanit për dijeni.
6. Ndjek realizimin e strukturës së programit të doktoraturës.
7. Ndjek zbatimin e planeve kërkimore të doktorantëve.
8. Organizon dhe ndjek procesin e prezantimeve periodike të doktorantëve për punën kërkimore të zhvilluar.
9. Vlerëson ecurinë procedurale të doktorantit dhe përmbushjen e detyrimeve të tij akademike, si dhe përgatit një raport përkatës që i drejtohet Komisionit të Përhershëm për Gradën Shkencore "Doktor", për të cilin jep rekomandimin mbi përgatitjen për mbrojtjen finale.

#### Neni 18 Udhëheqësi Shkencor

Udhëheqësi Shkencor i doktorantit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si dhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit punës kërkimore të tij. Ai ka këto detyra:

1. Në rast se e vlerëson të nevojshme, harton programin e detajuar për kualifikimin e thelluar teorik të studentit që ka pranuar për udhëheqje. Ky program përfshin temat e studimit, burimet shkencore, metodologjinë e kërkimit dhe afatet për realizimin e secilës fazë. Programi hartohet në bashkëpunim me drejtuesin e njesisë bazë dhe mund të përfshijë një ose disa module, të organizuara gjatë vitit të parë të studimit dhe të zhvilluara në dy javë me leksione ditore. Pas përfundimit të secilit modul, doktoranti vlerësohet nga lektori përgjegjës për këtë modul, për të siguruar përvetësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për hapat e mëtejshëm.
2. Formulon hipotezat kryesore të kërkimit shkencor që i ngarkon studentit për t'i verifikuar.
3. Miraton planin vjetor të punës së doktorantit, i cili hartohet në mënyrë të detajuar në nivel tremujor.
4. Në fund të çdo viti akademik shqyrton dhe miraton raportin e aktiviteteve të kryera nga doktoranti, duke e depozituar atë në dosjen e tij.
5. Garanton zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike gjatë periudhës së udhëheqjes së doktoraturës.
6. Udhëheq doktorantin në realizimin e kërkimit shkencor dhe përfundimin e disertacionit brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.
7. Siguron mbështetje akademike dhe konsulencë të vazhdueshme për arritjen e standardeve të larta kërkimore, duke përfshirë orientim në strukturën e punimit, metodologjinë, rekomandime për literaturën dhe burime të tjera informacioni.
8. Mban komunikim të rregullt me doktorantin për ecurinë e punës kërkimore.
9. Vlerëson progresin e doktorantit në mënyrë të rregullt dhe monitoron punën e tij sipas standardeve të kërkuara; ndërgjegjëson doktorantin dhe ndërmer veprime mbështetëse në rast se puna është nën standard.
10. Mbështet doktorantin në përgatitjen e materialeve kërkimore, përfshirë artikujt dhe prezantimet në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në botime të tjera shkencore që lidhen me tematikën e doktoraturës dhe përmbushin kriteret e përcaktuara.
11. Kontrollon që doktoranti të ketë plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet, sidomos në rastet kur njësia bazë ka kthyer punimin për riparaqitje ose plotësim të dokumentacionit.
12. Në rast bashkëudhëheqjeje, udhëheqësit përcaktojnë qartë përgjegjësitë dhe mbajnë kontakte të rregullta me njëri-tjetrin.
13. Ndërgjegjëson doktorantin për rreziqet e falsifikimit dhe plagjiaturës në kërkimin shkencor.



14. Shqyrton rezultatet e projektit kërkimor në përfundim dhe jep miratimin për fillimin e procedurave për mbrojtjen përfundimtare të disertacionit.
15. Në raste të jashtëzakonshme, udhëheqësi shkencor mund të zëvendësohet ose të transferojë të drejtën e drejtimit shkencor, në përputhje me këto rregulla:
- a. Rastet që justifikojnë zëvendësimin ose transferimin përfshijnë:
    - mungesë të arsyetuar afatgjatë;
    - largim nga institucioni;
    - konflikt interesi;
    - pamundësi objektive për vazhdimin e detyrës;
    - shkelje të rënda të etikës akademike ose të detyrimeve institucionale.
  - b. E drejta e drejtimit shkencor mund të transferohet ose t'i kalojë një udhëheqësi tjetër me titull akademik të përshtatshëm ("Profesor i Asociuar" ose "Profesor"), që plotëson kërkesat ligjore dhe akademike të përcaktuara nga universiteti.
  - c. Procedura e zëvendësimit apo transferimit niset me kërkesë me shkrim, e cila mund të paraqitet nga:
    - vetë udhëheqësi shkencor;
    - doktoranti;
    - njësia bazë.
    - Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar dhe e shoqëruar me dokumentacion mbështetës.
  - c. Kërkesa shqyrtohet fillimisht nga njësia bazë, e cila vlerëson arsyetimin, përshtatshmërinë e udhëheqësit të ri dhe garantimin e vijimësisë akademike. Pas miratimit nga njësia bazë, dosja i përcillet Komisionit për Graden Shkencore "Doktor" (KP), i cili merr vendimin përfundimtar me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm, duke respektuar kuorumin minimal prej më shumë se 50% të anëtarëve me të drejtë vote.
  - d. Në çdo rast zëvendësimi apo transferimi, duhet të ruhet kontinuiteti i punës kërkimore dhe të sigurohet kalimi i plotë i dokumentacionit, planeve vjetore dhe vlerësimeve të mëparshme të udhëheqësi i ri shkencor.

#### Neni 19

Personeli ndihmës akademik me karakter administrative për ciklin e tretë të studimeve

1. Për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës në programin e doktoraturës, caktohet Sekretaria e Doktoraturës, pjesë përbërëse e sekretarisë mësimore të Fakultetit.
2. Sekretaria përbëhet nga një ose më shumë persona me kohë të plotë, të cilët caktohen nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore.
3. Sekretaria e Doktoraturës kryen funksionet e mëposhtme:
  - a. Mban protokollin e programit të doktoraturës sipas ligjit për protokollin dhe arkivat;
  - b. Ruajtjen në formë elektronike dhe letre të gjithë dokumentacionit të aplikantëve dhe doktorantëve;
  - c. Pranon dhe administron kërkesat për konkurim për të drejtë studimi në ciklin e tretë;
  - d. Regjistron kandidatët konkurentë sipas njësive bazë;
  - e. Përgatit dosjet e kandidatëve për shqyrtim dhe i dorëzon komisioneve ad-hoc pranë departamenteve;
  - f. Asiston si mbajtës i protokollit në mbledhjet e Njesisë Bazë dhe Komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor", sipas udhëzimeve të Drejtuesit të Njesisë Bazë dhe Kryetarit të Komisionit;
  - g. Mban procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor";







- h. Përgatit dhe shpërndan dokumentacionin, procesverbalet, shkresat dhe materialet e tjera mësimore për zhvillimin e programit të doktoraturës;
- i. Afishon dhe njofton në mënyrë elektronike rezultatet e konkurimit për studimet e doktoraturës;
- j. Harton dhe mban regjistrin e studentëve që kryejnë studimet në ciklin e tretë "Doktoratë";
- k. Merr dhe shpërndan korrespondencën dhe materialet që lidhen me doktoraturën;
- l. Pret kërkesat dhe ankimet nga kandidatët ose doktorantët dhe i dërgon për shqyrtim tek organet përgjegjëse;
- m. Arkivon dokumentacionin në mënyrë shkresore dhe elektronike lidhur me programin e doktoraturës në njësinë bazë;
- n. Lajmëron dhe afishon informacione për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarive të programit të doktoraturës;
- o. Merr masa për ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit të doktoraturës nga rreziqet si zjarri, uji, dëmtimet dhe shpërdorimet.

#### Neni 20

##### **Komisioni për vlerësimin periodik të ecures së programit individual të Doktoratës**

- 1. Jo më vonë se një muaj pas miratimit të listës së kandidatëve për ciklin e tretë "Doktoratë", Drejtuesi i Njesisë Bazë krijon Komisionin për Vlerësimin Periodik (KVP), i cili miratohet nga Dekanati.
- 2. Komisioni përbëhet nga 3-5 anëtarë dhe është i veçantë për çdo doktorant, duke përfshirë:
  - a) Drejtuesin e Njesisë Bazë;
  - b) Udhëheqësin shkencor (pa të drejtë vote);
  - c) Dy deri në tre profesorë ose profesorë të asociuar të fushave të ngjashme, të caktuar nga Drejtuesi i Njesisë Bazë;
- 3. Në rastet kur njësia bazë nuk ka staf të kategorisë "profesor", KVP krijohet në bashkëpunim me departamente të tjera dhe miratohet nga Dekanati.
- 4. Komisioni organizon takime periodike me doktorantin, vlerëson dhe miraton prezantimet e punës së doktorantit bazuar në programin individual të dorëzuar në fillim të studimeve ("Organizimi i punës dhe fazat e aktiviteteve të parashikuara").
- 5. Pas çdo paraqitjeje të doktorantit para KVP-së, Komisioni del me vendim mbi ecurinë dhe rezultatet e prezantimit.
- 6. Gjatë periudhës së studimeve doktorale, doktoranti duhet të paraqitet të paktën pesë herë para Komisionit për Vlerësimin Periodik (KVP). Pas secilës paraqitjeje, Komisioni merr vendim për ecurinë e doktorantit, të cilat duhet të ruhen në dosjen e doktorantit si dëshmi e vlerësimit të vazhdueshëm.
- 7. Komisioni vendos për ecurinë e mëtejshme të punës për arritjen e objektivave shkencore dhe pritshmërive të parashikuara në projektin e kërkimit shkencor.
- 8. Me kërkesë të Udhëheqësit shkencor, Komisioni organizon paraqitjen e rezultateve përfundimtare të projektit të kërkimit në një mbledhje të hapur, ku ftohen të marrin pjesë të gjithë anëtarët e departamentit, si me kohë të plotë, ashtu edhe me kohë të pjesshme.

#### Neni 21

##### **Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor"**

Ky komision ka këto detyra:



- 
1. Analizën ecurinë e programit të doktoratës përmes shqyrtimit të raporteve vjetore të përgatitura nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe Koordinator i programit;
  2. Vlerëson dhe zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet midis drejtuesit shkencor dhe doktorantit; në rastet kur nuk arrihet zgjidhje, vendos për ndërprerjen e bashkëpunimit, e cila është masë përfundimtare dhe e paankimueshme;
  3. Shqyrton dosjen e kandidatit dhe, nëse konstaton që ajo përmban dokumentacionin e plotë dhe përmbush kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në shqyrtim, ngre Jurinë për vlerësimin e disertacionit;
  4. Ngren Jurinë e Vlerësimit të Disertacionit dhe përcakton oponentët dhe kryetarin e Jurisë, bazuar në propozimet e Njesisë Bazë dhe me miratimin e Dekanit;
  5. Pas analizës së raportit të Jurisë së Vlerësimit të Disertacionit, merr vendimin përfundimtar për dhënien e gradës shkencore "Doktor" dhe e përcjell atë Drejtuesit të Njesisë Kryesore për veprime të mëtejshme.

#### **Neni 22**

##### **Struktura e studimeve**

1. Viti akademik fillon në javën e parë të muajit Tetor dhe përfundon javën e fundit të muajit shtator të vitit pasardhës.
2. Studimet e doktoratës zgjasin tre vite akademike për studentët me kohë të plotë, dhe nga tre deri në pesë vite akademike për studentët me kohë të zgjatur. Pas përfundimit të studimeve, lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor".
3. Takimet midis udhëheqësit/udhëheqësve dhe doktorantëve duhet të dokumentohen dhe të përdoren gjatë shqyrtimit të raporteve të progresit në Njësinë Bazë.
4. Kur doktoranti është i punësuar si personel akademik ose kërkimor-shkencor në institucione të tjera të arsimit të lartë apo institucione të kërkimit bazë e të zbatuar, programi i doktoratës zhvillohet me kohë të zgjatur, për një periudhë më të gjatë se 3 vite, por jo më shumë se 5 vite akademike.

#### **KREU IV**

### **VEPRIMTARIA KËRKIMORE SHKENCORE, PËRGATITJA E DISERTACIONIT DHE DHËNIA E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"**

#### **Neni 23**

##### **Baza didaktike dhe mbështetja teknike**

Njësiti Bazë, nëpërmjet miratimit të projekteve, garantojnë për studentët e pranuar në programin e Doktoratës:

1. Kushtet e nevojshme për realizimin e programit të studimit me karakter akademik dhe shkencor.
2. Vënien në dispozicion të bibliotekës shkencore, të pasur me botime në format print dhe elektronik, si dhe infrastrukturën e plotë të teknologjisë së informacionit (IT).
3. Mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor
4. Bazën laboratorike të nevojshme për realizimin e kërkimit.

#### **Neni 24**

##### **Afatet kohore**





- 
1. Studenti i Doktoratës ka të drejtë të fillojë procedurat për mbrojtjen përfundimtare gjashtë muaj para përfundimit të tre viteve akademike, në rastin e studimit me kohë të plotë, dhe pas vitit të tretë për studimet me kohë të zgjatur.
  2. Programi i studimeve përcaktohet në marrëveshjen midis palëve sipas kësaj rregulloreje. Me kërkesë të studentit dhe justifikim të argumentuar nga udhëheqësi shkencor, periudha mund të zgjatet, por jo më shumë se dy vjet nga koha normale e studimit.
  3. Vendimi për shtyrjen e afatit formalizohet nga Komisioni i Përhershëm për gradën shkencore "Doktor" (KP).
  4. Periudha e studimeve mund të pezullohet për arsye sëmundjesh afatgjata ose rrethanash të paparashikuara, dhe kjo periudhë nuk llogaritet në afatin kohor të studimeve.
  5. Nëse punimi i doktoraturës nuk paraqitet për fillimin e procedurës së mbrojtjes brenda afatit të zgjatur pa justifikim bindës, Dekanati, me propozim të Njesisë Bazë, mund të ndërpresë vazhdimin e studimeve.
  6. Në rastet e shkeljes së rregulloreve, thyerjes së etikës akademike, mungesës së progresit të qëndrueshëm në punën kërkimore brenda afateve të përcaktuara, apo ndryshimeve të rëndësishme dhe të paautorizuara në projektin kërkimor, Njësia Bazë ka të drejtë të propozojë ndërprerjen e programit të doktoraturës para përfundimit të tij. Ky propozim i dërgohet Dekanatit për miratim përfundimtar, i cili merr vendimin përkatës.

#### Neni 25

##### Ndjekja e procesit të përgatitjes së kërimit shkencor dhe disertacionit.

1. Studentët e doktoratës kanë detyrimin të paraqesin ecurinë e punës së tyre kërkimore përpara Komisionit të Vlerësimit Periodik (KVP), në përputhje me planin individual të punës të miratuar në fillim të studimeve doktorale.
2. Procesi i ndjekjes së disertacionit përfshin të paktën pesë prezantime të detyrueshme përpara KVP-së, të strukturuar si më poshtë:
  - a. Prezantimi i parë: Objektivat e kërimit, pyetjet kërkimore, deklarata e problemit dhe struktura paraprake e studimit.
  - b. Prezantimi i dytë: Shqyrtimi i literaturës dhe ndërtimi i kuadrit teorik; formulimi i hipotezave ose qëllimeve të kërimit.
  - c. Prezantimi i tretë: Metodologjia e studimit, përzgjedhja e instrumenteve kërkimore dhe dizajni i analizës.
  - d. Prezantimi i katërt: Analiza e rezultateve të mbledhura dhe diskutimi paraprak mbi gjetjet.
  - e. Prezantimi i pestë: Gjetjet përfundimtare, diskutimet, konkluzionet dhe rekomandimet e studimit.
3. Studentët janë të detyruar të reflektojnë dhe të integrojnë në punën e tyre kërkimore sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna nga anëtarët e KVP-së gjatë prezantimeve.
4. Pas çdo prezantimi, KVP-ja miraton një vendim të dokumentuar, në të cilin pasqyrohet vlerësimi i punës së paraqitur dhe rekomandimet për vijimin e kërimit. Ky dokumentacion arkivohet në dosjen personale të studentit.
5. Çdo vit akademik, deri në muajin shtator, udhëheqësi shkencor përgatit një raport të detajuar mbi ecurinë e punës kërkimore të studentit dhe objektivat që mbeten për t'u realizuar. Këtij raporti i bashkëlidhen raporti i drejtuesit të njesisë bazë dhe i koordinatorit të programit të doktoratës. Progresi i plotë i dërgohet për miratim Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor".





6. Pas përfundimit të të pesë prezantimeve dhe me miratimin e udhëheqësit shkencor, studenti realizon mbrojtjen përfundimtare të dizertacionit në Departament.

#### Neni 26 Teza e Doktoratës

1. Vlerësimi përfundimtar i studentit të doktoratës bazohet në vlerësimin e punimit përfundimtar të kërkimit të tij shkencor.
2. Punimi përfundimtar i kërkimit shkencor të kandidatit për marrjen e gradës "Doktor" paraqitet në formën e disertacionit, i cili duhet të jetë i strukturuar sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcat përkatëse të kësaj rregulloreje.
3. Disertacioni duhet të jetë produkt i punës individuale të doktorantit dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilësisë akademike. Në të duhet të përshkruhen metodologjia e përdorur në kërkimin shkencor, rezultatet më të fundit në fushën përkatëse dhe kontributi i ri shkencor që sjell studimi në raport me këto rezultate.
4. Literatura e përdorur gjatë përgatitjes së disertacionit duhet të jetë e plotë, bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse.
5. Disertacioni hartohet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Kodi i Etikës në Kërkimin Shkencor i Universitetit.
6. Kriteret themelore që studenti duhet të përmbushë përpara mbrojtjes së disertacionit përcaktohen nga aktet nënligjore në fuqi. Në momentin e hartimit të kësaj rregulloreje, këto kriterë bazohen në VKM nr. 112, datë 23.02.2018, të ndryshuar me VKM nr. 128, datë 06.03.2024.
7. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbushë formatin e kërkuar nga Standardet e Cilësisë dhe Rregullorja e Studimeve të Ciklit të Tretë e UAMD-së. Disertacioni duhet të përfshijë një përmbledhje (nga 2000 deri në 4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian, dhe të dorëzohet në format të shtypur dhe elektronik. Disertacioni miratohet nga udhëheqësi shkencor.

#### Neni 27 Dorëzimi i tezës

1. Kandidati paraqet kërkesën për fillimin e procedurës për marrjen e gradës shkencore "Doktor", të firmosur nga vetë doktoranti dhe udhëheqësi shkencor/bashkëudhëheqësi, si dhe dorëzon disertacionin së bashku me dosjen përkatëse pranë Drejtuesit të Njesisë Kryesore. Pas dorëzimit të kërkesës, dosja nuk mund të tërhiqet deri në përfundimin e mbrojtjes publike të doktoraturës para Jurisë.
2. Drejtuesi i Njesisë Kryesore, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të dosjes, ia përcjell atë Njesisë Bazë për vlerësim.
3. Pas vlerësimit nga Njësia Bazë lidhur me plotësimin e kriterëve formale dhe pas kryerjes së kontrollit antiplagjiaturë, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënie të Gradës Shkencore "Doktor", brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, ngre Jurinë për vlerësimin e disertacionit brenda një afati tjetër prej 30 (tridhjetë) ditësh.
4. Dosja e doktorantit duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) Formularin e aplikimit për regjistrim në programin e doktoraturës, së bashku me dokumentacionin përkatës të kërkuar;
  - b) Dokumentin e regjistrimit në programin e studimeve të doktoraturës;







- c) Marrëveshjen e lidhur ndërmjet universitetit dhe doktorantit, sipas përcaktimeve të nenit 13 të kësaj rregulloreje;
  - d) Pesë vendimet e Komisionit të Vlerësimit Periodik (KVP) për prezantimet periodike;
  - e) Vlerësimet vjetore të udhëheqësit shkencor;
  - f) Dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për botimet shkencore dhe pjesëmarrjet në konferenca, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;
  - g) Lejen me shkrim të udhëheqësit shkencor për fillimin e procedurave të mbrojtjes;
  - h) Relacionin e detajuar të Drejtuesit të Njesisë Bazë;
  - i) Vërtetimin e përmbushjes së detyrimeve nga koordinatori i programit të doktoratës;
  - j) Çdo dokument tjetër që pasqyron marrëdhënien e doktorantit me universitetin.
5. Në rast se Njësia Bazë jep vlerësim negativ për dizertacionin ose për dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë dosjen e plotësuar me dizertacionin pas një periudhe jo më shpejt se 3 (tre) muaj<sup>1</sup> nga data e njoftimit të vlerësimit negativ.

#### Neni 28

#### Juria dhe Oponentët

1. Komisioni i Përhershëm për Gradën Shkencore “Doktor” përzgjedh anëtarët e Jurisë nga një listë me jo më pak se 8 (tetë) emra, të propozuar nga Njësia Bazë dhe të miratuar nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore. Anëtarët e Jurisë duhet t’i përkasin kategorisë “Profesor”.
2. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve 2 (dy) duhet të jenë nga njësi bazë ose kryesore të institucioneve homologe, vendase ose të huaja. Dy nga anëtarët e jurisë caktohen si oponentë për vlerësimin e disertacionit, nga të cilët njëri duhet të jetë anëtar i jashtëm. Njëri prej anëtarëve të jurisë caktohet si Kryetar i Jurisë.
3. Anëtarët e Jurisë duhet të jenë të gjithë të kategorisë “Profesor”.
4. Përveç 5 (pesë) anëtarëve të Jurisë, caktohen edhe 2 (dy) anëtarë zëvendësues, nga të cilët njëri duhet të jetë i brendshëm (nga Fakulteti i Biznesit, UAMD) dhe tjetri i jashtëm (nga institucione homologe vendase ose të huaja). Anëtarët zëvendësues duhet të përmbushin të njëjtat kritere si anëtarët e Jurisë dhe aktivizohen në rastet kur njëri nga anëtarët e Jurisë nuk mund të marrë pjesë në proces.
5. Në rast se, për arsye të justifikuara, njëri prej anëtarëve të Jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, përgjegjësi i Njesisë Bazë njofton Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe propozon një datë të re për mbrojtjen. Drejtuesi i Njesisë Kryesore vë në dijeni Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”. Juria vendos për ndryshimin e datës së mbrojtjes, pas miratimit paraprak nga Komisioni. E njëjta procedurë zbatohet edhe kur doktoranti, për arsye të justifikuara, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtje.
6. Nuk mund të caktohen si oponentë persona që kanë pasur një përfshirje substanciale në punën kërkimore të doktorantit ose kur puna e doktorantit mbështetet kryesisht në punën shkencore të tyre.
7. Udhëheqësi shkencor i doktorantit nuk mund të emërohet si oponent.
8. Oponentët dorëzojnë raportet e tyre vlerësuese pranë Kryetarit të Jurisë. Vlerësimet e tyre mund të përfshijnë një nga këto konkluzione:
  - a) Dhënien e gradës shkencore “Doktor”;
  - b) Riparaqitjen e disertacionit, me përmbushjen e rekomandimeve të dhëna;
  - c) Zgjatjen e mëtejshme të afatit të studimeve;

<sup>1</sup> (VKM 112, dt.23.02.2018, kreu I, pika 9).





- d) Refuzimin për dhënien e gradës shkencore.
9. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e formimit të saj nga Komisioni i Përhershëm për Gradën Shkencore "Doktor" dhe ia përcjell Drejtuesit të Njesisë Kryesore për shpallje publike.
10. Pas përfundimit të prezantimit të disertacionit nga doktoranti, Juria harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe ia dorëzon atë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".

#### Neni 29

##### Aktivizimi i anëtarëve zëvendësues të Jurisë

1. Në rast se një anëtar i Jurisë, për arsye të justifikuara, nuk mund të marrë pjesë në procesin e vlerësimit ose mbrojtjes së disertacionit, ai/ajo zëvendësohet menjëherë nga anëtar i zëvendësues përkatës.
2. Në rast mungese të anëtarit të Jurisë që është pjesë e brendshme, aktivizohet anëtar i zëvendësues i brendshëm.
3. Në rast mungese të anëtarit të Jurisë që është pjesë e jashtme, aktivizohet anëtar i zëvendësues i jashtëm.
4. Aktivizimi i anëtarëve zëvendësues bëhet me njoftim zyrtar nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore.
5. Anëtarët zëvendësues kanë të njëjtat kompetenca dhe detyrime si anëtarët kryesorë të Jurisë gjatë pjesëmarrjes në procesin e vlerësimit dhe mbrojtjes.

#### Neni 30

##### Mbrojtja Publike e Tezës së Doktoratës dhe Vlerësimi i Jurisë

1. Mbrojtja e tezës së doktoratës, si rregull, është publike.
2. Koha dhe vendi i zhvillimit të mbrojtjes njoftohen së paku 2 (dy) javë para datës së planifikuar. Gjatë kësaj periudhe, Departamenti vë në dispozicion të interesuarve një kopje të disertacionit për konsultim në vend.
3. Mbrojtja zhvillohet në prani të Jurisë, anëtarëve të Njesisë Bazë, studentëve, pedagogëve dhe të interesuarve të tjerë dhe kryhet sipas procedurës së mëposhtme:
  - a. Kryetari i Jurisë paraqet përmbajtjen e dosjes së doktorantit dhe konfirmon plotësinë e saj. Çdo anëtar ka të drejtë të verifikojë dosjen.
  - b. Lexohet vendimi për ngritjen e Jurisë.
  - c. Doktoranti paraqet një përmbledhje të arritjeve kërkimore (25–30 min).
  - d. Oponentët paraqesin raportet e tyre vlerësuese.
  - e. Anëtarët e Jurisë dhe pjesëmarrës të tjerë parashtrojnë pyetje.
  - f. Doktoranti, me ose pa konsultim me udhëheqësin, u përgjigjet pyetjeve.
  - g. Udhëheqësi jep vlerësimin e tij për nivelin shkencor të doktorantit.
  - h. Të pranishmit me titull shkencor "Doktor" mund të japin mendim mbi punimin.
  - i. Juria, në mënyrë të mbyllur, vendos me votim të fshehtë mbi vlerësimin e disertacionit.
4. Juria merr në konsideratë raportet e oponentëve dhe bën një vlerësim të përgjithshëm mbi mangësitë dhe arritjet e punimit.
5. Vlerësimi individual i secilit anëtar të Jurisë bëhet me votim të fshehtë, ku secili anëtar ka në dispozicion 1000 pikë, sipas shkallës:
  - a. Shkëlqyeshëm (935–1000)
  - b. Shumë mirë (845–934)
  - c. Mirë (650–844)
  - d. Mjaftueshëm (500–649)
  - e. Pakalueshëm (më pak se 500)





- 
6. Rezultati përfundimtar pasqyrohet në procesverbalin e mbrojtjes.
  7. Juria harton raportin përfundimtar të vlerësimit dhe, bashkë me fletët e votimit, e dorëzon dosjen pranë Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e mbrojtjes.
  8. brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e raportit të vlerësimit nga Juria, merr vendimin për dhënien e gradës "Doktor" dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme Drejtuesit të Njesisë Kryesore.
  9. Në rastet kur Juria konstaton mungesa në tezë dhe nuk aprovon mbrojtjen, lejohet dorëzimi i versionit të përmirësuar jo më shumë se dy herë, me afat të përcaktuar me marrëveshje midis doktorantit, udhëheqësit shkencor dhe Njesisë Bazë.

#### Neni 31

##### Dhënia e diplomës për gradën shkencore "Doktor"

1. Vendimi i Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", nëpërmjet Drejtuesit të Njesisë Kryesore, i dërgohet Rektoratit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, i cili përgatit dokumentacionin për instancat përkatëse.
2. Diploma për gradën shkencore "Doktor" lëshohet në përputhje me legjislacionin dhe VKM-të në fuqi.
3. Diploma i dorëzohet Doktorit të Shkencave në një ceremoni simbolike, e drejtuar nga Dekani i Fakultetit.
4. Pas përfundimit të procedurave të mbrojtjes, dosja e plotë e studentit të Doktoratës arkivohet në Arkivin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, së bashku me një kopje të dizertacionit së Doktoratës.
5. Një kopje e dizertacionit së Doktoratës së studentit që ka marrë diplomën për gradën "Doktor", në format të printuar dhe në CD, depozitohet në bibliotekën e Fakultetit, në bibliotekën e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në bibliotekat e institucioneve bashkëpunuese në kuadër të Programit të Doktoratës, si dhe një kopje depozitohet në Bibliotekën Kombëtare.
6. Diploma për gradën shkencore "Doktor" nuk lëshohet pa u depozituar dizertacioni në institucionet e sipërpërmendura dhe pa u bërë publike në faqen zyrtare të Universitetit "Aleksandër Moisiu".

#### Neni 32

##### Anulimi i Gradës "Doktor"

1. Grada shkencore "Doktor" mund të anulohet në çdo kohë dhe në çdo rast kur konstatohet plagjiaturë ose manipulim i dhënash në punimet e kandidatit. Në këtë rast, Dekani i kërkon Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" që të mblidhet menjëherë dhe të shqyrtojë rastin e konstatuar.
2. Vendimi përfundimtar merret nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe Komisioni i Etikës i Senatit të UAMD-së, të cilët i propozojnë Rektorit të UAMD-së anulimin e gradës shkencore "Doktor" të fituar padrejtësisht nga kandidati, bazuar në gjykimin dhe relatimin e Komisionit të Përhershëm të Fakultetit të Biznesit.
3. Rektori, pasi shqyrton rastin, merr vendim për ç'regjistrimin e gradës nga regjistri përkatës i UAMD-së dhe nga regjistri shtetëror i gradave dhe titujve akademikë në Ministrinë përgjegjëse (Ministria e Arsimit dhe Sportit).



- 
4. UAMD-ja ka të drejtë të revokojë gradën shkencore "Doktor" edhe në rastet kur konstatohet plagjiaturë apo manipulim të dhënash në studime ose punime kërkimore të kryera pas dhënies së gradës.
  5. Të gjithë palët e përfshira në procesin e studimeve të Doktoraturës duhet t'i referohen rregullores së UAMD-së mbi etikën në kërkimin shkencor.

## KREU V

### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE TE DOKTORATËS

#### Neni 33

##### Të drejtat e studentit të Doktoratës

1. Doktoranti ka të drejtë të përdorë të gjitha mjetet dhe burimet didaktike që janë në dispozicion të Drejtuesit të Njesisë Bazë, Drejtuesit të Njesisë Kryesore dhe Universitetit.
2. Doktoranti ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme shkencore, të lidhura ngushtë me fushën specifike të kërkimit që ai kryen në kuadër të studimeve të Doktoratës.
3. Doktoranti duhet të angazhohet në mësimdhënie në programet e ciklit të parë dhe të dytë, si në praktika, seminare ose si lektor, në mbështetje dhe bashkëpunim me udhëheqësin e tij shkencor. Ngarkesa mësimore dhe pagesa për doktorantin përcaktohen sipas rregullave të statutit të universitetit.
4. Doktoranti ka të drejtë të aplikojë për bursa pranë Universitetit, si dhe pranë organizmave të tjera shoqërore dhe financiare, vendase apo të huaja, për të përballuar shpenzimet e studimeve të Doktoratës.
5. Doktoranti ka të drejtë të vetëfinancojë studimet e tij të Doktoratës.
6. Doktoranti gëzon të gjitha të drejtat e tjera të pashprehura në këtë rregullore, të cilat i gëzojnë studentët e regjistruar në UAMD, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### Neni 34

##### Detyrat e studentit të Doktoratës

1. Doktorata realizohet si një produkt i përbashkët ku kontribuojnë studenti, drejtuesi shkencor dhe Njësia Bazë. Në këtë bashkëpunim, përgjegjësia kryesore për ecurinë i takon doktorantit.
2. Doktoranti duhet të njihet dhe të zbatojë në çdo rast rregullat, rregulloren e Doktoratës, statutin e universitetit dhe kërkesat e tjera të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të cilat i bëhen me dije.
3. Doktoranti duhet të ndjekë me korrektësi të gjitha modulet teorike që i konsiderohen të nevojshme nga udhëheqësi shkencor.
4. Doktoranti duhet të përmbushë të gjitha detyrimet financiare brenda afateve të përcaktuara nga administrata e universitetit.
5. Doktoranti duhet të përmbushë detyrimet akademike për botimet shkencore, në përputhje me VKM-në për kriteret e fitimit të gradës shkencore "Doktor".
6. Doktoranti duhet të zbatojë me përpikmëri dhe profesionalizëm planin kalendarik të realizimit të studimeve të tij doktorales.

## KREU VI

### FINANCIMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS







#### Neni 35

##### Burimet e financimit

Studimet e Doktoratës mund të financohen nga burime të ndryshme, përfshirë:

1. Projekte kërkimore shkencore të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).
2. Projekte kërkimore shkencore të miratuara nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës.
3. Financime nga subjekte të treta, publike apo private, vendase ose të huaja.
4. Vetëfinancimi nga vetë studenti i Doktoratës.
5. Vetëfinancimi i studimeve të Doktoratës bëhet në bazë të një marrëveshjeje të firmosur nga ana e studentit të Doktoratës, Udhëheqësit Shkencor, drejtuesit të Njesisë Bazë.
6. Modeli i kontratës, elementët e saj, si dhe kostoja e studimeve miratohen nga ana e Bordit të Administrimit.
7. Kontrata e vetëfinancimit miratohet dhe nga ana e Administratorit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës".

#### Neni 36

##### Tarifat e studimeve

1. Tarifa e studimeve të doktoratës përcaktohet me vendim të Bordit të Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Pagesa e tarifës kryhet në fillim të çdo viti akademik, sipas procedurave të përcaktuara nga administrata e universitetit.

### KREU VII

#### VULA ZYRTARE DHE LOGO

#### Neni 37

##### Vula dhe Logo

Programi i studimeve të doktoratës në Shkenca Ekonomike përdor vulën zyrtare dhe logon e Fakultetit të Biznesit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

### KREU VIII

#### DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 38

1. Amza dhe dokumentacioni tjetër ligjor i programit të doktoratës administrohet nga Kryesekretarja e Fakultetit të Biznesit.
2. Për administrimin e dokumentacionit të procedurës së doktoratës për çdo doktorant, përgjegjës është nënpunësi ndihmës mësimor i ngarkuar.
3. I gjithë dokumentacioni i ecursisë së doktorantit ruhet në tre kopje:
  - a. Një kopje ruhet në Njësinë Bazë përkatëse,
  - b. Një kopje nga Zv. Dekani përgjegjës për ciklin e tretë,
  - c. Një kopje ruhet në arkivën e Fakultetit.



Neni 39

Zbatueshmëria, ndryshimet dhe interpretimi i Rregullores

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë studentët aktualë të programit të doktoratës si dhe për ata që do të nisin studimet në të ardhmen.
2. Rregullorja mund të përsoset ose të ndryshohet në përputhje me zhvillimet akademike dhe institucionale, si dhe me nevojat e reja të Programit të studimeve të doktoratës në Shkenca Ekonomike ose ndryshimet në strukturën administrative. Ndryshimet bëhen nëpërmjet amendamenteve ose përmes një rishikimi tërësor të saj. Një kopje e rregullores ruhet në Rektorat dhe një tjetër në protokollin e Fakultetit të Biznesit.
3. E drejta e interpretimit të kësaj rregulloreje i takon Dekanatit të Fakultetit të Biznesit.
4. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.







## SHTOJCA 1

Projekt-propozim individual për kërkim shkencor Programi i studimeve: Doktoratë në Shkenca Ekonomike

- Fusha e kërkimit shkencor: \_\_\_\_\_
- Miratuar me vendim të Departamentit nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_
- Profesori që ka propozuar fushën e studimit dhe idenë e projektit: \_\_\_\_\_
- Tema e projektit individual të kërkimit shkencor: \_\_\_\_\_

### Përmbajtja

#### 1. Hyrje

Hyrja paraqet një pasqyrë të përgjithshme të kërkimit shkencor të propozuar. Ajo identifikon problemin kryesor që synohet të adresohet dhe kontekstin në të cilin lind ky problem. Fillimisht, përshkruhet sfondi i kërkimit dhe çështjet themelore që lidhen me temën, duke theksuar rëndësinë e tyre. Më pas, pasqyrohen objektivat kërkimore të shprehur përmes pyetjeve apo hipotezave shkencore. Gjithashtu, përcaktohen kufijtë e kërkimit dhe ndikimi i pritshëm i rezultateve në fushën përkatëse. Hyrja duhet të shkruhet qartë dhe të zgjojë interesin e lexuesit. Ajo përfundon me një përmbledhje të shkurtër të kapitujve që përbëjnë dokumentin.

#### 2. Qëllimi, qasja dhe risia

Ky seksion paraqet qëllimin e përgjithshëm dhe objektivat specifike të kërkimit. Qartësohet rëndësia shkencore dhe praktike e studimit dhe shpjegohet qasja teorike/metodologjike që do të përdoret. Gjithashtu, identifikohet boshllëku teorik ose praktik që kërkimi synon të mbushë dhe evidentohet kontributi potencial që risia e këtij projekti sjell në fushën përkatëse.

#### 3. Mbështetja teorike dhe rishikimi i literaturës

Kjo pjesë përmbledh literaturën më relevante lidhur me temën e kërkimit. Qëllimi është të tregojë njohjen e thelluar të fushës dhe çështjeve kyçe të saj, si dhe të argumentojë nevojën për kërkimin e propozuar. Analizohet qasja e studimeve të mëparshme dhe identifikohet boshllëku që mbetet për t'u mbushur. Sipas rastit, mund të përfshihet edhe harta e literaturës për të paraqitur vizualisht lidhjet ndërmjet koncepteve dhe teorive ekzistuese.

#### 4. Metodologjia

Në këtë pjesë përshkruhen hapat e detajuar që do të ndiqen për të realizuar kërkimin. Sqarohen metodat e përdorura për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, burimet, instrumentet, si dhe kriteret për përzgjedhjen e kampionit. Jepet një justifikim i zgjedhjes së metodave në përputhje me qëllimet e kërkimit dhe natyrën e të dhënave. Përcaktohen gjithashtu variablat e pavarur dhe të varur, nëse aplikohen.

#### 5. Analiza e të dhënave

Në këtë seksion përshkruhet se si do të analizohen të dhënat e mbledhura. Nëse përdoren metoda sasiore, specifikohen teknikat statistikore dhe programet që do të përdoren për analizë. Në rast të metodave cilësore, përshkruhet qasja analitike e ndjekur. Qëllimi është të demonstrohet koherenca ndërmjet të dhënave, metodës dhe pyetjeve kërkimore.

#### 6. Limitimet dhe delimitimet

Limitimet janë faktorë të jashtëm që kufizojnë zbatueshmërinë e rezultateve dhe që nuk varen nga studiuesi. Delimitimet janë kufizime që vendosen nga vetë studiuesi për të përqendruar kërkimin. Të dyja duhet të paraqiten qartë dhe të arsyetohen, pasi ndikojnë në interpretimin e rezultateve dhe në gjeneralizimin e tyre.

#### 7. Konkluzionet



Ky seksion përmbledh objektivat kryesore të kërkimit dhe risitë e tij, duke sqaruar pritshmëritë në lidhje me rezultatet. Gjithashtu, tregon rëndësinë shkencore të studimit dhe mënyrën se si do të vlerësohet vlefshmëria e tij.

#### 8. Referencat

Këtu renditen të gjitha burimet e përdorura në përgatitjen e propozimit kërkimor. Duhet të zgjidhet dhe respektohet një stil citimi i unifikuar (p.sh., APA, Chicago, MLA), i cili të përdoret në mënyrë konsistente në të gjithë dokumentin.





**SHTOJCA 2**  
**KËRKESA TË PËRGJITHSHME TË DISERTACIONIT**



**1. Përputhshmëria me formatin**

Disertacioni duhet të përmbushë të gjitha kërkesat formale. Nëse nuk përputhet me to, nuk pranohet derisa të korrektohet.

**2. Lidhja dhe kopertina**

Disertacioni duhet të jetë i lidhur si libër me kopertinë kartoni. Në kopertinë, me ngjyrë të zezë, duhet të vendoset:

- Emri i Universitetit
- Emri i Fakultetit
- Njësia bazë
- Programi i Doktoratës
- Titulli i plotë i temës (me shkronja kapitale, font 18, në gjysmën e sipërme dhe në qendër të kopertinës)
- Emri i kandidatit
- Emri i udhëheqësit shkencor
- Viti i mbrojtjes

**3. Gjatësia**

Nuk ka kufizim të rreptë për gjatësinë, por zakonisht duhet të jetë jo më pak se 100 faqe.

**4. Formati i printimit**

- Formati A4 (21 cm x 29.7 cm)
- Letër e bardhë, cilësi e mirë
- Printim vetëm nga njëra anë e faqes
- Teksti duhet të shtypet me kompjuter, dorëshkrimet nuk pranohen
- Font: Times Neë Roman, madhësia 12
- Hapësira: 1 ndërmjet radhëve
- Numrat e faqeve: poshtë, në qendër të faqes
- Margjinat:
  - Sipër: 1"
  - Poshtë: 1"
  - Majtas: 1.25"
  - Djathtas: 1.25"

**5. Shënime, tabela dhe figura**

- Shënimet të shkruhen në mënyrë kompjuterike
- Tabelat të vendosen brenda tekstit, të qendruara, me:
  - Numër arab dhe emërtim përpara tabelës (p.sh. Tabela 2.1)
  - Font: Times Neë Roman 12, bold
  - Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër, legjenda nuk përsëritet
- Diagramet/Figurat:
  - Të vendosen në faqe përkatëse
  - "Figura", numri arab dhe përshkrimi vendosen poshtë diagramës
  - Nëse vazhdojnë në faqe tjetër, ndiqen të njëjtat rregulla si për tabelat





- Fotografitë më të vogla se një foto vendosen në faqen përkatëse
- Materialet shtesë (CD, video etj.) duhet të bashkëngjiten kur janë pjesë përbërëse e punimit

**6. Autoreferati**

- Doktoranti përgatit një autoreferat (përmbledhje e tezës) me:
  - Rreth 30 faqe, format A5
  - 12 kopje
  - Një kopje i jepet secilit anëtar të Komisionit të Përhershëm të Dhënies së Gradës “Doktor” dhe Komisionit Vlerësues

**7. Shembuj dhe udhëzime shtesë**

- Të gjitha detajet teknike, përfshirë shembuj të zbatimit, jepen nga Përgjegjësi i Programit të Studimeve “Doktoratë”.







SHTOJCA 3

## MODELI I TEZËS SË DOKTORATËS

Në faqen e parë shkruhet, në pozicionin e mesit dhe me shkrim të qendëruar:

“ Copyright, # I# Emri, Mbiemri i studentit, # Viti” (Shënim: shenja # është përdorur për të treguar fillimin e një rrjeshti të ri)

Në faqen e dytë, në pozicionin e sipërm, shkruhet me shkrim të qendëruar:

Udhëheqësi i \_Emri e mbiemri i studentit\_ vërteton se ky është version i miratuar i disertacionit të mëposhtëm: dhe në 1/3 e faqes shkruhet Titulli i disertacionit me gërma kapitale me shkrim 16, Times Neë Roman. Më poshtë, me hapësirë të trefishtë, shkruhet, në të djathtë Emri e Mbiemri i Udhëheqësit shkencor dhe i bashkëudhëheqësit (nëse ka një të tillë) dhe vendosen firmat përkatëse.

Në faqen e tretë, në pozicionin sipër, me shkrim të qendëruar, rishkruhet Titulli i disertacionit, me gërma kapitale dhe shkrim 16 Times Neë Roman. Në pozicionin 1/3 të faqes shkruhet Përgatitur nga: Grada e mëparshme (shkurtim) Emri Mbiemri i studentit. Më poshtë, me hapësirë trefishe, shkruhet me shkrim të qendëruar teksti:

“Disertacion i paraqitur në # Fakulteti i \_\_\_\_\_ # Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës # Në përputhje të plotë# Me kërkesat# Për gradën “Doktor”. Faqja mbyllet me shkrimin Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës # Muaji, Viti.

Në faqen e katërt shkruhet “Dedikim” i cili është fakultativ

Në faqen e pestë shkruhet “Mirënjohje/falenderim” i cili është fakultativ

Në faqen e gjashtë shkruhet teksti i mëposhtëm:

Deklaratë mbi originalitetin

Emri Mbiemri

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të shkruajtura nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat. Tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam i/ e vetëdijshme/shme se në rast të mospërputhjeve, mbaj përgjegjësi ligjore

Durrës, më \_\_\_\_\_ Firma

Në faqen e shtatë dhe tetë vendoset Përmbledhja deri në një faqe , në shqip e anglisht, në fund të së cilës vendosen 4-6 fjalë kyç.

Në faqen nëntë **“Përmbajtja e lëndës”** që duhet të jetë e detajuar: Kapitujt, titujt dhe nëntitujt e çdo kapitulli dhe numri përkatës i faqes. Në vijim jepet **Lista e Tabelave** dhe **Lista e Figurave**, e shoqëruar me numrin e faqes ku ndodhet secila prej tyre.



Më tej, vazhdon paraqitja e lëndës së tezës në kapitujt e mëposhtëm:

1) Hyrja, 2) Literatura e shqyrtuar; 3) Metodologjia e ndjekur dhe instrumentat e përdorur 4) Analiza e rezultateve dhe gjetjet 5) Diskutimi i rezultateve, konkluzionet dhe rekomandimet. Disertacioni të mbyllet me a) Apendikset dhe b) Bibliografia.

#### **Lloji i shkrimit sipas niveleve:**

1. Titulli kryesor ose Titulli i kapitullit: Times Neë Roman, Bold, 16 all capital, hanging 0.3, hapësira para dhe pas tij 2.

1.1 Niveli i parë: Times Neë Roman, Bold, 14, small capital, hanging 0.4, hapësira para dhe pas tij 6.

1.1.1 Niveli i dytë: Times Neë Roman, Bold, 14, hanging 0.4, hapësira para dhe pas tij 6.

1.1.1.1 Niveli i tretë: Times Neë Roman, Bold dhe italic, 14, hanging 0.6, hapësira para dhe pas tij 6. Në fund të materialit të tezës jepet një CV e shkurtër, deri në 1 faqe e autorit të tezës (fakultative).

#### **Formati i literaturës në stilin APA**

##### Citimi i revistave

Mbiemri i autorit, Gërma e parë e emrit, Mbiemri i autorit, Gërma e parë e emrit., (viti) : Titulli i materialit. Emri i revistës, viti, Vol(nr): f.xx-xx.

##### Citimi i librave

Mbiemri i autorit, Iniciali i emrit. (Viti i botimit). Titulli i librit (Botimi, nëse është i dyti ose më shumë). Emri i botuesit. F.xx-xx

##### Citimi i kapitujve të librave

Mbiemri, Iniciali. (Viti). Titulli i kapitullit. In Iniciali. Mbiemri (Ed.), Titulli i librit (faqet xx-xx). Emri i botuesit.

##### Citimi i tezave të disertacionit

Mbiemri i autorit, Gërma e parë e emrit: Titulli i disertacionit. PhD Dissertacion. Emri i Universitetit, shteti, viti.

##### Citimi i proceeding të botuara

Autori, Iniciali. (Viti). Titulli i punimit. Iniciali. Mbiemri (Ed.), *Titulli i proceedings-it* (Volumi, fq. xx-xx). Botuesi. <https://doi.org> ose URL (nëse ka)

##### Citim i materialeve të pabotuara

Mbiemri, Iniciali., & Mbiemri, Iniciali. (në shtyp). Titulli i artikullit. *Emri i revistës*. In press.

Pjesa e pasme e kopertinës së disertacionit duhet të përmbajë:

**Abstrakti në shqip dhe në anglisht.** Secili variant duhet të përmbajë 200 fjalë duke u përdorur masa 10-she e shkronjës. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marë në studim. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standarteve ndërkombëtare.

**Fushën dhe fjalët kyçe.** Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.





# AKT MARRËVESHJE PËR NDJEKJEN E STUDIMEVE NË PROGRAMIN E DOKTORATËS NË SHKENCA EKONOMIKE

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe në Rregulloren e Programit "Doktoratë" në Shkenca Ekonomike, sot më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ lidhet kjo Akt Marrëveshje me objekt realizimin e studimeve në Programin Doktoratë në Shkenca Ekonomike, pranë Fakultetit të Biznesit, UAMD, mes palëve si më poshtë:

- |          |                                             |
|----------|---------------------------------------------|
| 1. _____ | Drejtues i Departamentit _____              |
| 2. _____ | Koordinator i Programit të Doktoratës _____ |
| 3. _____ | Drejtues Shkencor _____                     |
| 4. _____ | Student i Doktoratës _____                  |
| 5. _____ |                                             |

Rezultatet e arritura në programin e doktoratës janë në pronësi të përbashkët midis doktorantit, udhëheqësit shkencor dhe departamentit përkatës.  
Të drejtat dhe detyrimet e palëve rregullohen nga kuadri ligjor për studimet e doktoraturës në Republikën e Shqipërisë dhe nga ky akt marrëveshjeje.

## I. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DEPARTAMENTIT

1. Departamenti garanton për studentin e programit Doktoratë:
  - a. Kushtet e nevojshme për realizimin e programit akademik-shkencor.
  - b. Vënien në dispozicion të bibliotekës shkencore, me botime të printuara dhe elektronike, si dhe infrastrukturë të plotë IT.
  - c. Mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor.
  - d. Bazën laboratorike të nevojshme.
  - e. Financimin e pjesës së aktiviteteve kërkimore në përputhje me përcaktimet e projektit:
2. Në përputhje me rregulloren e doktoratës, departamenti ndjek zbatimin e projektit të studimeve:
  - a. Krijon Komisionin e vlerësimit periodik.
  - b. Organizon prezantimet periodike të doktorantit.
  - c. Bën vlerësimin përfundimtar të disertacionit.
3. Drejtuesi i Departamentit, në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor dhe në përputhje me programin dhe projektin e kërkimit:
  - a. Harton planin individual për aftësimin e doktorantit për përvetësimin e njohurive të thelluara shkencore dhe metodologjisë së kërkimit, dhe njofton koordinatoren.
  - b. Organizon zhvillimin e procesit për zbatimin e planit individual, duke përfshirë angazhimin e doktorantit në mësimdhënie, përveç kur vendoset ndryshe.
  - c. Organizon kontrollin dhe vlerësimin periodik të ecurisë së kërkimit shkencor.
  - d. Harton strukturën e studimeve kur është e nevojshme.
  - e. Merr parasysh dhe shqyrton kërkesat e veçanta të doktorantit.





## II. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DREJTUESIT SHKENCOR

Drejtuesi shkencor ka të drejtë dhe përgjegjësi për:

- Drejtimin e projektit të kërkimit shkencor të doktorantit në të gjitha fazat e tij.
- Hartimin e planit të thellimit teorik të doktorantit.
- Miratimin e planit vjetor të doktorantit në bashkëpunim me koordinatorin dhe drejtuesin e departamentit.
- Shqyrtimin dhe miratimin e raportit të aktiviteteve të doktorantit.
- Paraprakisht jep mendimin për shtyrjen e afatit të studimeve.
- Pas përfundimit të kërkimit, i propozon drejtuesit të departamentit fillimin e procedurave për mbrojtjen e disertacionit.

## III. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KOORDINATORIT TË PROGRAMIT TË DOKTORATËS

Koordinatori i programit ka këto të drejta dhe detyrime:

- Harton në bashkëpunim me udhëheqësin dhe drejtuesin e departamentit planin individual të kërkimit shkencor.
- Shërben si hallkë ndërmjetëse administrative mes doktorantit dhe administratës së Universitetit.
- Ndjek zbatimin e strukturës së programit të doktoratës.
- Organizon prezantimet periodike të doktorantit.
- Mban informacionin nga drejtuesi shkencor mbi ecurinë e doktorantit.
- Vlerëson ecurinë procedurale të doktorantit deri në përmbushjen e detyrimeve për mbrojtjen e disertacionit.

## IV. DETYRIMET E DOKTORANTIT (STUDENTIT TË PROGRAMIT DOKTORATË)

- Të ndjekë studimet me kohë të zgjatur, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 dhe Rregulloren e programit të doktoratës, ku afati varion nga 3 deri në 5 vite akademike, duke filluar nga viti akademik 2023-2024, me regjistrim në Sekretarinë e Fakultetit të Biznesit pranë UAMD, brenda datës \_\_\_\_\_. Me regjistrimin fiton statusin e doktorantit dhe të gjitha të drejtat përkatëse.
- Të njohë dhe zbatojë Rregulloren e Programit Doktoratë dhe UAMD-së, si dhe kërkesat e planit dhe programeve mësimore.
- Të përmbushë në kohë detyrimet e programeve mësimore, praktikës dhe tezës së doktoraturës.
- Të paguajë taksën e regjistrimit prej 5,000 lekësh deri më datë \_\_\_\_\_, si dhe tarifën e shkollimit sipas përcaktimeve të Bordi të Administrimit dhe afateve të UAMD.
- Të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të programit dhe të kompensojë dëmet materiale që mund t'i shkaktojnë institucionit.
- Në rast mosmarrëveshjes me drejtuesin shkencor, të kërkojë zgjidhjen përmes Koordinatorit të Programit të Doktoratës, në përputhje me Rregulloren.

## V. KUSHTET PËR PARAQITJEN E DISERTACIONIT PËR MBROJTJE

Para mbrojtjes, doktoranti duhet të ketë përmbushur këto:

- Të ketë qenë autor i parë (ose i dytë kur autor i parë është drejtuesi shkencor) në të paktën tre referime ose paraqitje shkencore, prej të cilave të paktën dy në konferenca ndërkombëtare brenda BE-së, OECD-së ose G20, të pranura dhe botuar në Proceedings me ISBN ose ISSN.







UNIVERSITETI I SHQIPËRIE

2. Të ketë botuar së paku tre artikuj shkencorë, prej të cilëve një në revista të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku është autor i paktën i dytë, në përputhje me VKM Nr. 808, datë 11.12.2019.
3. Të ketë përgatitur dhe dorëzuar disertacionin me përmbledhje të miratuar nga drejtuesi shkencor, sipas Rregullores së Programit të Doktoratës.
4. Të garantojë zbatimin e Kodit të Etikës për veprimtarinë shkencore dhe botuese.

STUDENTI

DREJTUESI SHKENCOR

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

KOORDINATORI I DOKTORATURËS



SHTOJCA 5

MODEL MARREVESHJE BASHKEPUNIMI



UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU  
DURRËS

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

Fakultetit të Biznesit

DHE

---

Duke parë nevojën për bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe mirëkuptimin dypalësh, në mënyrë që të lehtësohet kryerja e funksioneve të tyre përkatëse

**BIEN DAKORT:**

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

Neni 1

**PARIME TË PËRGJITHSHME**

1. Kjo marrëveshje ka për qëllim zhvillimin e bashkëpunimit në realizimin e projekteve të përbashkëta për realizimin e programit të studimit të doktoratës.
  2. Bashkëpunimi do të bëhet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat në fuqi që rregullojnë kuadrin ligjor të funksionimit të dy njësive bazë;
- Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore.







Neni 2

## NJËSITË BAZË NËNSHKRUESE

Departamenti \_\_\_\_\_, Fakulteti Bizesit, vepron në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07. 2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Departamenti \_\_\_\_\_, Fakulteti \_\_\_\_\_, vepron në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07. 2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 3

## QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i procedurës dhe vendosja e rregullave të bashkëpunimit midis dy departamenteve nënshkruese në mënyrë që të sigurohet:

- 3.1. Bashkëpunimi në procesin e kërkimit shkencor për aspekte konkrete që janë në fushën e ekspertizës së departamenteve respektive;
- 3.2. Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta kerkimore shkencore.

Neni 4

## FORMAT E BASHKËPUNIMIT

Personeli akademik i departamenteve nënshkruese do të angazhohet në realizimin e projekteve kerkimore brenda programit të doktoraturës zhvillohen në departamentet respektive, sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë programin e studimit të doktoraturës.

Neni 5

## PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE KONFIDENCIALITETI

1. Pronësia e rezultateve të kërkimit shkencor dhe disertacioni janë pronë e departamentit të Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, të Fakultetit të Biznesit.
2. Departamenti \_\_\_\_\_, i Fakultetit të Biznesit, është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 6

## SHQYRTIMI I MARRËVESHJES

Departamentet nënshkruese, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe ndryshimet eventuale në fushat e kërkimit shkencor që ato mbulojnë, do të rishikojnë vazhdimisht zbatimin e kësaj.

Neni 7





## DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Çdo rregullim ose ndryshim sipas nenit 6, në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, mund të kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok me shkrim të palëve.
2. Palët duhet t'i përgjigjen propozimeve reciproke për rregullime ose ndryshime, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së këtij propozimi.
3. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
4. Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të përfundojë me njoftimin me shkrim të secilës palë, një muaj pas këtij njoftimi.
5. Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një afat 5 vjeçar, me të drejte rinovimi.

### Neni 8

Kjo marrëveshje hartohet në katër kopje dhe secila nga palët mban dy kopje në origjinal.







Rregullore e Programit të Studimit Doktoratë në Shkenca Ekonomike, Fakulteti i Biznesit

UNIVERSITETI  
"ALEKSANDËR MOISIU"  
FAKULTETI I BIZNESIT

Durrës, më \_\_\_\_\_

UNIVERSITETI  
Universiteti

FAKULTETI I \_\_\_\_\_

Dekani

